



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 28 tetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Haxhi Shalës për Informacion lidhur me
Disponueshmërinë e Sallës së Gjyqit**

Gjykatësit e Trupit Gjykses I:

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, Gjykatës rezervë

Mbrojtjes së Sabit Januzit:

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Zyrës së Prokurores së Specializuar:

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit:

Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës:

Tobi Kadman

Xhon Kabën

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke marrë parasysh nenin 32(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullën 13(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara,¹ lëshon vendimin mbi Mocionin e Haxhi Shalës për Informacion në lidhje me Disponueshmërinë e një Salle të Gjyqit Shtesë (“Mocioni”).²

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 11 dhjetor 2023, z. Shala u arrestua në Kosovë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij bazuar në pretendimet për frikësim të dëshmitarëve.³ Më 12 dhjetor 2023, z. Shala u transferua në Njësinë e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, Holandë.⁴

2. Më 4 shtator 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi Trupit Gjykues I dosjen e çështjes KSC-BC-2023-10.⁵

3. Më 6 shtator 2024, Trupit Gjykues I u dërgoi palëve një mesazh elektronik ku u kërkonte disponueshmërinë e tyre për seanca gjyqësore “duke pasur parasysh disponueshmërinë e kufizuar të sallës së gjyqit gjatë muajve të ardhshëm” për

¹ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, (miratuar më 17 mars 2017, rishikuar më 29 maj 2017, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020).

² F00488, Mocion i Haxhi Shalës për Informacion në lidhje me Disponueshmërinë një Salle të Gjyqit Shtesë, 30 shtator 2024.

³ KSC-BC-2023-11/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës, 30 janar 2024 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 4 dhjetor 2023, riklasifikuar si konfidencial më 12 dhjetor 2023) (“Aktakuza e Konfirmuar”); KSC-BC-2023-11/F00013/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Konfirmuar, 12 dhjetor 2023. Versioni konfidencial i Aktakuzës u dorëzua më 6 dhjetor 2023. Shih KSC-BC-2023-11/F00007/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar, 6 dhjetor 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* riklasifikuar si konfidencial më 11 dhjetor 2023).

⁴ KSC-BC-2023-11/F00015/RED, Versione të redaktuara publike të Raportit për Arrestimin dhe Transferimin e Haxhi Shalës në Objektin e Paraburgimit me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *Ex Parte*, 3 korrik 2024 (“Raporti”) (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* dorëzuar më 13 dhjetor 2023, riklasifikuar si konfidencial më 15 dhjetor 2023).

⁵ F00468, Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes Trupit Gjykues I, 4 shtator 2024.

periudha të caktuara në tetor, nëntor dhe dhjetor 2024.⁶

4. Më 9 shtator 2024, Trupi Gjykses I u dërgoi një mesazh elektronik palëve ku u kërkonte disponueshmërinë e tyre gjatë datave shtesë në janar, shkurt dhe mars 2025.⁷

5. Më 13 shtator 2024, z. Shala i dorëzoi një mocion Trupit Gjykses I, ku i kërkonte informacion për disponueshmërinë e sallës së gjyqit të Dhomave të Specializuara, me qëllim minimizimin e “mundësisë së zgjatjes së tepruar të gjykimit”.⁸

6. Më 24 shtator 2024, Trupi Gjykses I lëshoi Vendimin për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin, për Parashtrime nga Palët dhe për Çështje të Lidhura me Të (“Vendimi për Caktimin e Datave”), ku, ndër të tjera, shprehej se “nuk është organi i duhur për t’iu përgjigjur” pyetjeve të z. Shala lidhur me informacion për disponueshmërinë e sallës së gjyqit.⁹ Trupi Gjykses I deklaroi më tej se kërkesa e tij drejtuar palëve në lidhje me disponueshmërinë e tyre për muajt e vëna në dukje “nuk është përcaktues për kohëzgjatjen e pritshme të gjykimit apo për orët e seancave në këtë çështje”.¹⁰

7. Më 30 shtator 2024, z. Shala dorëzoi Mocionin.

8. Më 11 tetor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar dorëzoi Përgjigjen e Prokurorisë ndaj Mocionit të Shalës për Disponueshmërinë e Sallës së Gjyqit (“Përgjigja”).¹¹

9. Më 21 tetor 2024, z. Shala dorëzoi Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë

⁶ Mocioni, para. 4.

⁷ Mocioni, para. 5.

⁸ Mocioni, para. 6.

⁹ F00479, Vendim për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin, për Parashtrime nga Palët dhe për Çështje të Lidhura me Të, 24 shtator 2024, para. 10.

¹⁰ Vendim për Caktimin e Datave, para. 10.

¹¹ F00522, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Shalës për Disponueshmërinë e Sallës së Gjyqit, 11 tetor 2024.

lidhur me Mocionin për Disponueshmërinë e Sallës së Gjyqit (“Kundërpërgjigja”).¹²

10. Më 24 tetor 2024, Trupi Gjykues I lëshoi Vendimin mbi Datën e Fillimit të Gjykimit (“Vendimi për Fillimin e Gjykimit”).¹³

II. PARASHTRIMET

10. Z. Shala parashtrohet se datat e parashikuara aktualisht për seancat gjyqësore nga Trupi Gjykues I “nënkuptojnë se gjykimi nuk do të zhvillohet gjatë ditëve të njëpasnjëshme të punës dhe as kryesisht gjatë ditëve të njëpasnjëshme të punës”, duke rezultuar në ndërprerje prej disa ditësh dhe javësh.¹⁴ Z. Shala parashtrohet se “periudha e zgjatur gjatë të cilës me sa duket Trupi Gjykues parasheh zhvillimin e seancave gjyqësore do të ishte në të keqen e të akuzuarit i cili ka shprehur shqetësim lidhur me kohën e gjykimit, duke qenë se vazhdon të mbahet në paraburgim”.¹⁵

11. Z. Shala pranon se Trupi Gjykues I nuk ka marrë ende vendim lidhur me kohën e zhvillimit të procesit gjyqësor në rastin e tij, por deklaron se rrethanat “janë të tilla që, për shkak të kohëzgjatjes, ka rrezik që drejtat e të akuzuarit të shkelen”.¹⁶ Rrjedhimisht, z. Shala pretendon se “ka të drejtë” të dijë se përse nuk janë marrë masa që të mbahen seancat gjyqësore brenda një kohe të shkurtër.¹⁷ Meqenëse Trupi Gjykues I nuk e konsideroi veten si “organi i duhur” për t’iu përgjigjur pyetjeve të z. Shala lidhur me sallën e gjyqit, rrjedhimisht, ai ia drejtoi ato Kryetares.¹⁸

12. ZPS-ja pretendon se Mocioni duhet “hedhur poshtë si i parakohshëm, hamendësues dhe i pabazuar,” duke qenë se nuk ka asnjë tregues se gjyqi nuk do të

¹² F00546, Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Mocionin për Disponueshmërinë e Sallës së Gjyqit, 21 tetor 2024.

¹³ F00559, Vendim mbi Datën e Fillimit të Gjykimit, 24 tetor 2024.

¹⁴ Mocioni, para. 13.

¹⁵ Mocioni, para. 17. *Shih gjithashtu* Mocionin, para. 14-16; Kundërpërgjigjen, para. 7-9.

¹⁶ Mocioni, para. 18.

¹⁷ Mocioni, para. 19.

¹⁸ Mocioni, para. 20-21.

zhvillohet në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë.¹⁹ ZPS-ja argumenton se, përkundrazi, Trupi Gjykses I e ka bërë të ditur që deklaratat hyrëse do të mbahen më 8 nëntor 2024, dhe do të pasohen nga paraqitja e provave nga ZPS-ja një javë më vonë, më 11 nëntor 2024.²⁰

Z. Shala pretendon se nëse u jepen përgjigje pyetjeve që ai ka bërë “dhe atyre që janë para Trupit Gjykses, do të mund t’i bëhen parashtrime të tjera Trupit Gjykses me qëllim që rreziku të minimizohet apo edhe të zhduket plotësisht”.²¹ Z. Shala parashtron set “parandalimi është më i mirë se kurimi,” kështu që Mocioni nuk mund të konsiderohet i parakohshëm, hamendësues dhe i pabazë.²²

III. DISKUTIM

13. Kryetarja vëren se kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara nuk i ofron asnjë bazë dhe as “të drejtë” një të akuzuari që të kërkojë informacion nga Kryetarja lidhur me mënyrën se si organizohen seancat gjyqësore nga Trupi Gjykses. Ndërsa Kryetarja është përgjegjëse për administrimin gjyqësor të Dhomave të Specializuara, organizimi i seancave gjyqësore para Dhomave të Specializuara, duke përfshirë planifikimin e seancave të gjykatës, është një çështje plotësisht në kompetencën e Trupit Gjykses.

14. Kryetarja kujton më tej se në Vendimin për Caktimin e Datave, Trupi Gjykses I sqaroi se kërkesa e tij në lidhje me disponueshmërinë e palëve gjatë disa muajve të caktuar nuk përbën ndonjë vendim për kohëzgjatjen e pritshme të gjykimit dhe se në fakt ai nuk ka planifikuar ndonjë datë për seancat gjyqësore.

15. Kryetarja konstaton në këtë drejtim se datat konkrete për deklaratat hyrëse të palëve dhe fillimin e paraqitjes së provave nga ZPS-ja u bënë të njohura nga Trupi

¹⁹ Përgjigja, para. 1. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para, 2-3.

²⁰ Përgjigja, para. 1.

²¹ Kundërpërgjigja, para. 8.

²² Kundërpërgjigja, para. 8, 10.

Gjykues I në Vendimin për Fillimin e Gjykimit.²³

16. Kryetarja vëren më tej se në Mocionin e tij, z. Shala nuk ngre ndonjë argument lidhur me vonesat aktuale apo të vazhdueshme të procesit para Trupit Gjykues I. Për sa i takon ndonjë shqetësimi që z. Shala sa i përket shpejtësisë së procesit në rastin e tij, Kryetarja kujton se kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara ofron garanci dhe mjete ligjore të mjaftueshme nëpërmjet të cilave mund të ngrihen shqetësime në qoftë se ato në fakt materializohen.

17. Në bazë të sa më sipër, kërkesa e z. Shala për informacion lidhur me përdorimin e sallës së gjyqit duhet hedhur poshtë.

IV. VENDIM

Për arsytet e lartpërmendura, Kryetarja **E HEDH POSHTË** Mocionin në tërësi.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E Hënë, 28 tetor 2024
Në Hagë,
Holandë

²³ F00559, Vendim mbi Datën e Fillimit të Gjykimit, 24 tetor 2024, para. 6, 9, 15. Në Vendimin për Fillimin e Gjykimit, Trupi Gjykues I vuri në dukje “se të gjitha palët janë gati për të filluar gjykimin në nëntor 2024” dhe pasi ndryshoi afatin e paraparë në rregullën 118(3) të Rregullores, ai “vendosi që gjyqi të fillojë të enjten, 14 nëntor 2024, në orën 09:30”. Për më tepër, pasi shqyrtoi parashtrimet e palëve lidhur me datën e parapëlqyer për to për deklaratat hyrëse, Trupi Gjykues vendosi “të dëgjojë deklaratat hyrëse duke filluar të enjten, 14 nëntor 2024, në orën 9:30, pas hapjes së çështjes [...] dhe se do të vazhdojë të premten, 15 nëntor 2024, nëse është e nevojshme”. Lidhur me paraqitjen e provave, Trupi Gjykues I deklaroi se “duke marrë parasysh kërkesat e kohëve të fundit nga të gjitha palët për ndihmë në këtë çështje gjyqësore për të siguruar dëshmi të tjera, të cilat kanë ndikim në paraqitjen e provave dhe kryerjen e shpejtë të procesit, Trupi Gjykues vendosi që paraqitja e provave nga ZPS-ja të fillojë të hënë, 9 dhjetor 2024, në orën 9:30”.